



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2020:059556

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05506596

**C.nr.447/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditëses N.XH nga Mitrovica të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.Kadri Osaj, kundër të paditurve 1.Ndërmarrja “Kosova Trans” – NP “Stacioni i Autobusëve – Mitrovicë”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Migjen Voca dhe 2.Komuna e Mitrovicës Jugore të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.Arbnor Murturi, me objekt kontesti: Anulim vendimi dhe kompensim dëmi, pas mbajtje se shqyrtimit kryesor, me datën 26.03.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses N.XH, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Bordit të Drejtorëve të NP “Stacioni i Autobusëve” nr.01 i datës 20.10.2014 mbi shkarkimin e paditëses dhe të obligohen në mënyrë solidare të paditurat që paditëses t’ia kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe atë shumën bruto në lartësi prej 8,161.29€, ku nga kjo shumë 7,321.40€ t’i paguhen paditëses, ndërsa shuma 408.06€ në emër të kontributit të të punësuarit dhe 408.06€ në emër të kontributit të punëdhënësit për Trustin Pensional të paguhen në llogari të Trustit Pensional, ndërsa shuma prej 431.83€ të paguhet në llogari të ATK-së si dhe kamata ligjore në lartësi prej 4,939.79€, **si e pabazuar**.
- II. OBLIGOHET** paditësja N.XH, që të paditurës Komunës së Mitrovicës, t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 540.80€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### **Arsyetim**

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të të paditurës së parë Ndërmarrja “Kosova Trans” – Stacioni i Autobusëve – Mitrovicë komfor nenit 423 paragrafi 4 i LPK-së.

#### **1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

Paditësja me datën 31.01.2017, pranë kësaj gjykata ka paraqitur padi të cilën e ka precizuar në seancës e datës 21.03.2024, kundër të paditurve 1.Ndërmarrja “Kosova Trans” – Stacioni i Autobusëve – Mitrovicë dhe 2.Komuna e Mitrovicës Jugore me të cilën ka kërkuar që të anulohet

vendimi i Bordit të Drejtorëve NPL” Kosova Trans” nr. 01 i dt. 20.10.2014 mbi shkarkimin e paditëses dhe të obligohen në mënyrë solidare të paditurat që paditëses t`ia kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe atë shumën bruto prej 8161.29 €, ku nga kjo shumë bruto 7321.40 € t`i paguhet paditëses, ndërsa shuma 408.06 € në emër të Trustit Pensional në emër të të punësuarit dhe 408 € në emër të punëdhënësit të paguhet në llogari të Trustit, ndërsa shuma prej 431.83 € të paguhet në llogari të ATK-së si dhe kamata ligjore në lartësi prej 4,939.79€ për periudhën kohore të llogaritur dhe ajo vijuese në shumën prej 8% prej momentit që nuk është llogaritur deri në pagesën definitive.

I autorizuari i paditëses në fjalën përfundimtare deklaroj se nga provat e administruara deri më tani është dëshmuar se aktvendimi kontestues është nxjerr në kundërshtim me kushtet e parapara për shkëputjen e kontratës, të paraparë me kontratën për krijimin e marrëdhënies së punës dhe se ky aktvendim është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Marrëdhënien e Punës. Vendimi i Bordit për shkarkim është nxjerr nën ndikimin e Komisionit të Aksionarëve i cili vendim i Komisionit të Aksionarëve duke marrë parasysh ligjin në fuqi dhe aktet nënligjore, duke marrë parasysh se ndërmarrja publike “Stacioni i Autobusëve” Shoqëri Aksionare i ka organet e veta të pavarura dhe se përmes organeve të veta do të kishte shqyrtuar përformacën e saj si kryeshefe e ndërmarrjes dhe do të kishte vlerësuar se i ka plotësuar obligimet e parapara me statut dhe aktet e tjera nënligjore. Andaj, përgjegjës në këtë çështje është Komuna ngase Komisioni i Këshillit të Aksionarëve ka nxjerr një vendim që nuk është kompetent e gjithashtu përgjegjës është edhe Bordi i Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve si shoqëri aksionare ngase ka zbatuar vendimet e Këshillit të Aksionarëve. Vlerësimi i Komisionit bjen në kundërshtim edhe me provat të cilat ne i kemi deponuar e posaçërisht me certifikatën e biznesit ngase transformimi i shoqërisë nga KTU “Ndërmarrja Trans” është bërë një muaj para se të nxjerrët ky vendim, konkretisht me datën 26.09.2014 kurse kërkesa është bërë me 15.05.2013 dhe se neglizhenca e regjistrimit nuk ka qenë te kryeshefja por tek autoritetet e regjistrimit tek ARBK-ja e cila në mënyrë burokratike ka zvarrit procesin e transformimit dhe se pretendimi i tyre duke marrë parasysh të lartëcekurat nuk qëndron. Gjithashtu nuk qëndrojnë edhe pretendimet e Këshillit Aksionar dhe të Bordit në lidhje me përformancën e saj dhe në lidhje me raportet me vartësit e saj, ngase nga dokumentacionet e ofruara dëshmohet qartë se përforma e paditëses është vlerësuar me pikët maksimale si dhe vlerësimi i vartësve të saj ndaj paditëses është pozitiv. Andaj në bazë të lartëcekurave gjykatës i propozoj që të miratohet kërkesëpadija e paditëses si e bazuar, të anulohet vendimi i Bordit të Drejtorëve NPL” Kosova Trans” nr. 01 i dt. 20.10.2014 mbi shkarkimin e paditëses, dhe të obligohen në mënyrë solidare të paditurat që paditëses t`ia kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe atë shumën bruto prej 8,161.29€, ku nga kjo shumë bruto 7321.40€ t`i paguhet paditëses, ndërsa shuma 408.06€ në emër të Trustit Pensional në emër të të punësuarit dhe 408€ në emër të punëdhënësit të paguhet në llogari të Trustit, ndërsa shuma prej 431.83€ të paguhet në llogari të ATK-së si dhe kamata ligjore në lartësi prej 4,939.79€ për periudhën kohore të llogaritur dhe ajo vijuese në shumën prej 8% prej momentit që nuk është llogaritur deri në pagesën definitive. Gjithashtu paditëses t`i paguhet shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizë 150€, për padi 104€, për 11 seanca nga 135.20 € shumën prej 1,487.20€ si dhe për ankesë shumën prej 208 € dhe shumën prej 80 € në emër të taksave gjyqësore, të gjitha këto të i paguhet paditëses prej momentit kur aktgjykimi të bëhet i plotëfuqishëm.

I autorizuari i të paditurës së dytë – Komuna e Mitrovicës Jugore, në fjalën përfundimtare deklaroi se në bazë të vendimit me numër 01/2013 të dt. 12.01.2013 paditësja është emëruar në pozitën Kryeshefe Ekzekutive nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Mitrovicë dhe ka lidhur kontratë pune me datën 04.02.2013 me Bordin e Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Sh.A. Po ashtu Bordi i kësaj ndërmarrje e ka marrë edhe vendimin e kontestuar për shkarkimin e paditëses nga detyra e kryeshefes ekzekutive. Paditësja ka pranuar pagë nga Ndërmarrja Stacioni i Autobusëve Sh.A., e cila ndërmarrje ka pasur buxhetin e saj me të cilin ka menaxhuar ekskluzivisht Bordi i Drejtorëve të kësaj ndërmarrje. Ndërsa, e paditura Komuna e Mitrovicës së Jugut asnjëherë nuk ka paguar paga për paditësen dhe me asnjë organ të saj nuk ka menaxhuar me ndërmarrjen “Stacioni i Autobusëve”Sh.A., në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike konkretisht me anë të nenit 5 par.2 si dhe nenit 7 par.6 përcaktohet që Komisioni Komunal i Aksionarëve ka vetëm rol mbikëqyrës ndaj Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike, mirëpo nuk ka kompetenca që të menaxhoj me ndërmarrjen në fjalë dhe as të shfrytëzoj buxhetin e ndërmarrjes për të paguar punëtorët e ndërmarrjes. Duke pasur parasysh faktin që paditësja nuk ka themeluar marrëdhënie punë me Komunën e Mitrovicës së Jugut si dhe nuk është paguar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut por ka krijuar marrëdhënien e punës me Ndërmarrjen Stacioni i Autobusëve Sh.A., si dhe ka pranuar pagë nga kjo ndërmarrje, atëherë Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk mund të detyrohet të paguaj dëmin për shkak të pagave të cilat nuk i janë paguar nga ndërmarrja publike Stacioni i Autobusëve Sh.A., rrjedhimisht, duke pasur parasysh edhe faktin që vendimin e kontestuar nuk e ka nxjerrur Komuna e Mitrovicës së Jugut e njëjta nuk mund të jetë përgjegjëse për kompensimin ndaj paditëses dhe nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje. Duke u bazuar në të gjitha këto fakte i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i kërkojn në shumën prej 540.80 € në emër të mbajtjes së dy seancave gjyqësore.

## ***2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor***

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ekspertiza financiare e dt. 23.11.2023 si dhe plotësimi i saj i dt. 14.03.2024, vërtetimi i përvojës së punës i dt. 19.03.2024, aktvendimi mbi pushimin vjetor i datës 15.08.2014, njoftimi për kundërshtim të vendimit për shkarkimin e kryeshefes nr. 158/a i dt. 27.10.2014, certifikata e biznesit për NPL”Stacioni i Autobusëve”Sh.A., kontrata e punës për N.XH nr. 18/a e dt. 04.02.2013, vendimi nr.01/2013 i dt. 12.01.2013, vendimi nr. 01 i dt. 20.10.2014, vlerësimi i punës për N.XH për periudhën 01.02.2013 – 31.01.2014, vendimi nr. 01/12 i dt. 09.11.2012, vendimi nr.01/2012 i dt.29.12.2012, raporti i punës për periudhën Janar - Dhjetor 2013 dhe Janar – Shtator 2014 për ndërmarrjen NPL”Stacioni i Autobusëve” Sh.A, statuti i NPL” Stacioni i Autobusëve” Sh.A ”, nr. 02/06 -6747/12 i dt. 28.03.2013 së bashku me aneks statutin e dt. 22.04.2013, vendimi nr.02/06-8048/5 i dt.27.03.2014, vendimi nr.01-18020 i dt. 14.05.2014, shkresa me nr.73/2014 e dt.19.05.2014, njoftimi nr.13-031-28754 i dt.17.07.2014, vërejtja me shkrim e dt.21.07.2014, njoftimi nr.155/2014 i dt.08.10.2014, kërkesa e dt. 31.07.2014, vendimi nr.05/2014 i dt. 20.08.2014, aneks vendimi nr. 06/2014 i dt. 20.08.2014 dhe njoftimi nr.156/2014 i dt. 08.10.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **e pabazuar**.

### 3. Faktet

Me leximin e vendimi nr. 01/12 i dt. 09.11.2012, gjykata vërtetojë faktin se Kuvendi Komunal me datën 06.11.2012, ka emëruar drejtorët e Bordit të NP “Stacioni i Autobusëve”.

Me leximin e vendimit nr.01/2012 i dt.29.12.2012, gjykata vërtetojë faktin se bordi i drejtorëve të NP “Stacioni i Autobusëve” ka nxjerr vendim për shpalljen e konkursit publik për Kryeshef Ekzekutiv.

Me leximin e vendimit nr. 01/2013 i dt. 12.01.2013, gjykata vërtetojë faktin se me këtë vendim paditësja është emëruar Kryeshef Ekzekutiv në NP”Stacioni i Autobusëve” Mitrovicë.

Me leximin e kontratës së punës për N.XH nr.18/a e dt. 04.02.2013, gjykata vërtetojë faktin se paditësja ka lidhur kontratë të punës me të paditurën NP “Stacioni i Autobusëve” Sh.A, për pozitën Kryeshefe Ekzekutive, me kohë të caktuar duke filluar nga data 15.01.2013 deri me datën 14.01.2016.

Me leximin e vendimit nr.02/06-8048/5 i dt.27.03.2014, gjykata vërtetojë faktin se Kuvendi Komunal i Mitrovicës, formojë Komisioni Komunal të Aksionarëve të NP “Stacioni i Autobusëve”.

Me leximin e vendimit nr.01-18020 i dt. 14.05.2014, gjykata vërtetojë faktin se me datën 14.05.2014, Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP “Stacioni i Autobusëve” shkarkojë Bordin e Drejtorëve të kësaj ndërmarrje.

Me leximin e vendimit nr. 01 i dt. 20.10.2014, gjykata vërtetojë faktin se paditësja është shkarkuar nga pozita e Kryeshefes Ekzekutive të NP “Stacioni i Autobusëve” Sh.A me datën 20.10.2014.

Me leximin e njoftimit për kundërshtim të vendimit për shkarkimin e kryeshefes nr. 158/a i dt. 27.10.2014, gjykata vërtetojë faktin se paditësja e ka njoftuar Kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Grupet parlamentare të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Kryesuesin e Komisionit të Aksionarëve të NP ”Stacioni i Autobusëve” dhe Sekretarin e Kuvendit Komunal të Mitrovicës se nuk do të respektojë vendimin për shkarkimin e saj nga posti i Kryeshefes Ekzekutive.

Me leximin e vërtetimit të përvojës së punës i dt. 19.03.2024, gjykata vërtetojë faktin se paditësja ka qenë anëtare e Bordit të Drejtorëve të KRM “Uniteti” Sh.A, nga data 31.07.2009 deri me 05.04.2016.

Me leximin e njoftimit nr.156/2014 i dt. 08.10.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësja me datën 08.10.2014 e ka njoftuar Kryetarin e Komunës së ndërmarrja NPL”Stacioni i Autobusëve” Sh.A është regjistruar si shoqëri aksionare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe ndërmarrja NPL”Stacioni i Autobusëve” Sh.A, nuk bartë asnjë obligim nga KTU-Kosovatrans.

Me leximin e aktvendimit mbi pushimin vjetor i datës 15.08.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka qenë në pushim vjetor nga data 18.08.2014 deri me 16.09.2014.

Me leximin e vlerësimit të punës për N.XH për periudhën 01.02.2013 – 31.01.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditëses i është bërë vlerësimi i performancës për këtë periudhë dhe e njëjta është vlerësuar se ka rezultate të suksesshme në ndërmarrje ( NP “Stacioni i Autobusëve”).

Me leximin e raportit të punës për periudhën Janar - Dhjetor 2013 dhe Janar – Shtator 2014 për ndërmarrjen NPL”Stacioni i Autobusëve” Sh.A, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka paraqitur raportin e punës së saj për këtë periudhë.

Me leximin e Statutit të NPL” Stacioni i Autobusëve” Sh.A ”, nr. 02/06 -6747/12 i dt. 28.03.2013 së bashku me aneksin e statutin e dt. 22.04.2013, gjykata vërtetoi faktin se kjo ndërmarrje ka nxjerrë Statutin e saj me datën 28.03.2013.

Me leximin e shkresës me nr.73/2014 e dt.19.05.2014, gjykata vërtetoi faktin se Kryetari i Komisionit Komunal të Aksionarëve Kosovatrans – Stacioni i Autobusëve, ka kërkuar nga menaxhmenti i NP “Stacioni i Autobusëve” zbatimin e vendimeve të nxjerra nga Ministri, Kryetari i Komunës dhe Komisioni Komunal i Aksionarëve.

Me leximin e njoftimit nr.13-031-28754 i dt.17.07.2014, njoftimit nr.155/2014 i dt.08.10.2014 dhe vërejtjes me shkrim e dt.21.07.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësja i ka shqiptuar vërejtje drejtorit operativ të NPL”Stacioni i Autobusëve”.

Me leximin e kërkesës së dt. 31.07.2014, gjykata vërtetoi faktin se Kryetari i Komisionit Komunal të Aksionarëve për NP “Stacioni i Autobusëve” ka kërkuar nga Menaxhmenti i NP “Stacioni i Autobusëve” respektimin e ligjshmërisë lidhur me lëshimin e dokumenteve zyrtare.

Me leximin e vendimit nr.05/2014 i dt. 20.08.2014 dhe aneksin e vendimit nr. 06/2014 i dt. 20.08.2014, gjykata vërtetoi faktin se Komisioni Komunal i Aksionarëve i vazhdoi mandatin Bordit të Drejtorëve të Përkohshëm të NP “Stacioni i Autobusëve” dhe vendosi për pagesën e të njëjtëve.

Me leximin e certifikatës së biznesit për NPL”Stacioni i Autobusëve” Sh.A, gjykata vërtetoi faktin se e paditura NPL “Stacioni i Autobusëve” është Shoqëri Aksionare e regjistruar pranë Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë që nga data 26.09.2014.

Me leximin ekspertizës financiare e dt. 23.11.2023 si dhe plotësimi i saj i dt. 14.03.2024, gjykata vërtetoi faktin se lartësia e paga të cilat do t’i merrte paditësja si Kryeshefe e NPL “Stacioni i

Autobusëve” është në lartësi prej 8,161.29€ bruto, ku përfshihen paga neto në lartësi prej 7,321.40€, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin Pensional në emër të të punësuarit në shumën prej 408.06€, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit në shumën prej 408.06€, tatimi në paga që duhet paguar në dobi të Buxhetit të Kosovës në shumën prej 431.83€, ndërsa kamata ligjore për këtë detyrim është në shumën prej 7,027.55€.

#### **4. Ligji i aplikueshëm**

Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 I Ligjit për Ndërmarrjet Publike, parashihet që *“Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarinimin e arsyes.”* Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni parasheh që *“Secila NP do të ketë këta katër zyrtarë në vijim: (i) Kryeshefin Ekzekutiv, (ii) Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, (iii) Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarin e Korporativ dhe (iv) një Zyrtar për Auditim të Brendshëm.”*

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare, parashihet që *“Shoqëria aksionare është person juridik në pronësi të aksionarëve të saj por është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët. Aksionari i një shoqërie aksionare nuk është bashkë-pronar dhe nuk ka interes të transferueshëm në pronën ose asetet e shoqërisë. Një shoqëri aksionare mund të ketë vetëm një aksionar.”*

Në bazë të nenit 128 paragrafi 1 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare, parashihet që *“Shoqëria aksionare është përgjegjëse për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj.”* Ndërsa, paragrafi 2 I këtij neni parasheh që *“Asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është aksionar në këtë shoqëri.”*

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 i Statutit nr.02/06-6747/12 i dates 28.03.2013, i Ndërmarrjes Publike “Stacioni i Autobusëve” Sh.A,( tutje Statutit i NP “Stacioni i Autobusëve”), parashihet që *“Komuna e Mitrovicës, është aksionare e ndërmarrjes, me kapital publik”.* Ndërsa neni 13 paragrafi 2 i këtij Statuti parasheh *“Aksionar i vetëm i ndërmarrjes është Komuna e Mitrovicës”*

Në bazë të nenit 15 të Statutit të NP “Stacioni i Autobusëve”, parashihet që *“Zyrtarët e Ndërmarrjes do të jenë Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm, Sekretari dhe zyrtarët e tjerë të caktuar nga Bordi i Drejtorëve.”*, ndërsa neni 14 paragrafi 4 i këtij Statuti, parasheh që *“Drejtori tjetër është Kryeshefi Ekzekutiv i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes, në përputhje me nenin 21 të Ligjit për Ndërmarrjes Publike.”*

#### **5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës**

Gjykata, pas administrimit dhe vlerësimit të provave vërtetojë faktin se Komuna e Mitrovicës me datën 06.11.2012, ka emëruar drejtorët e Bordit të NP “Stacioni i Autobusëve”, pastaj ky bord me datën 12.01.2013 ka zgjedhur paditësen si Kryeshefe Ekzekutive të NP “Stacioni i Autobusëve” Sh.A., dhe kanë lidhur kontratën e punës për paditësen për periudhën nga data 15.01.2013 e deri me 14.01.2016. Mirëpo, Kuvendi Komunal i Mitrovicës me datën 14.05.2014, ka shkarkuar Bordin e NP “Stacioni i Autobusëve” Sh.A., dhe ka emëruar anëtarë tjerë në këtë bord. Ndërsa, Bordi i Drejtorëve me anë të vendimit nr.01 i dt. 20.10.2014, ka shkarkuar nga pozita e Kryeshefes Ekzekutive të NP “Stacioni i Autobusëve” Sh.A me datën 20.10.2014. Andaj, paditësja me anë të padisë e ka goditur vendimin mbi shkarkimin dhe ka kërkuar që i njëjti të anulohet dhe kësajsoj objekt i shqyrtimit të kësaj çështje kontestimore është vendimi nr.01 i datës 20.10.2014 mbi shkarkimin e paditëses nga pozita e Kryeshefes Ekzekutive të NP “Stacioni i Autobusëve”.

Gjykata, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, ka vërtetuar se shkarkimi i paditëses nga pozita e Kryeshefes Ekzekutive të NP “Stacioni i Autobusëve” është bërë në përputhje me dispozitën e nenit 21 paragrafi 1 dhe 3 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike e cila parasheh se Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre dhe se Kryeshefi Ekzekutiv është njëri nga këta zyrtarë. Shkarkimi i paditëses nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv është bërë edhe në përputhje me kontratën e punës e datës 04.02.2013 e cila në nenin 19 parasheh që “Secila palë mund ta shkëpus këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj dhe me Kontratën Kolektive”.

Gjykata, vlerëson se Ligji për Ndërmarrjet Publike, është ligj special i cili përcakton mënyrën dhe kushtet për emërim të zyrtarëve kryesor, përfshirë këtu edhe Kryeshefin Ekzekutiv, si dhe mënyrën e shkarkimit të këtyre zyrtarëve. Në këtë rast, gjykata vlerëson se Ligji i Punës nuk zbatohet me rastin e emërimit dhe shkarkimit të këtyrë zyrtarëve e as ligjet e tjera nga marrëdhënia e punës sepse për këto pozita zbatohet ekskluzivisht Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe i përjashton të gjitha ligjet e tjera. Kësajsoj, gjykata vlerëson se kontrata e punës së paditëses nuk ka paraparë kushte specifike për shkëputjen e kontratës së punës, mirëpo vetëm i është referuar ligji, e në këtë rast ligji është Ligji për Ndërmarrjet Publike.

Paditësja, pretendon se e njëjta ka përmbushur detyrat e punës sa ka qenë Kryeshefe Ekzekutive dhe për këtë arsye shkarkimi i saj ka qenë i kundërligjshëm, mirëpo nga leximi i vendimit mbi shkarkimin e të njëjtës gjykata vëren se shkarkimi ka të bëjë me rënien e performancës së ndërmarrjes si dhe dështimi i paditëses në menaxhimin e operacioneve të ndërmarrjes, andaj gjykata vlerëson se vlerësimin e këtyrë çështjeve që lidhen me performancën e ndërmarrjes dhe përmbushjen e detyrave nga ana e paditëses mund ta vlerësojë vetëm punëdhënësi pra në këtë rast NP “Stacioni i Autobusëve” e jo gjykata, sepse nuk është në juridiksionin e gjykatës të merret me menaxhimin, operimin apo performancën e ndërmarrjes sepse këto janë interes i përgjegjësve të ndërmarrjes dhe punëdhënësve në përgjithësi të cilët kujdesen për ngritjen e performancës dhe ngritjen e kapaciteteve financiar ku operojnë, ndërsa gjykata në këtë rast vlerëson se a janë respektuar të drejtat e punëtorëve me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës dhe a është bërë shkëputja komfor dispozitave ligjore pozitive që e rregullojnë një gjë të tillë.

Gjykata, vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesëpadisë e bëri vetëm karshi të paditurës së parë pra NP “Stacioni i Autobusëve” sepse vetëm e paditura e parë ka legjitimitet pasiv në këtë çështje. Kjo, për shkak se nga provat e administruara e posaçërisht certifikata e biznesit për të paditurën e parë, gjykata vërtetohet faktin se e njëjta është Shoqëri Aksionare dhe sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria Aksionare është person juridik në pronësi të aksionarëve të saj por është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët dhe se asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është aksionar në këtë shoqëri. Andaj, pavarësisht faktit se Komuna e Mitrovicës është aksionari i vetëm i NP “Stacioni i Autobusëve”, e njëjta nuk përgjigjet për detyrimet e kësaj ndërmarrje, pasi që juridikisht është e ndarë nga ajo. NP “Stacioni i Autobusëve” në këtë rast, e ka Bordin e Drejtorëve si organi më i lartë i ndërmarrjes dhe menaxhmentin e ndërmarrjes i cili zgjedhet nga ky Bord, ndërsa lidhur me detyrimet e ndërmarrjes, ndërmarrja menaxhon me asetet e saj dhe është përgjegjëse për detyrimet e veta me mjetet e veta financiare.

Me këtë rast, gjykata vlerëson se refuzimi i padisë karshi Komunës së Mitrovicës, është tërësisht për shkak se e njëjta nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje dhe jo duke u lëshuar në vlerësimin e meritave të kërkesëpadisë, sepse ky vlerësim është bërë vetëm karshi të paditurës së parë “NP Stacioni i Autobusëve”.

Gjykata, pati parasysh edhe vërejtjet e Gjykatës së Apelit në këtë çështje kontestimore, lidhur me çështjen e konkursit në bazë të të cilit paditësja është emëruar në pozitën e Kryeshefes Ekzekutive të NP “Stacioni i Autobusëve”, mirëpo gjykata vlerësojë se meqenëse paditësja kishte lidhur kontratën e punës me të paditurën e parë dhe për shkak të shkarkimit nga kjo pozitë kishte kërkuar anulimin e vendimit mbi shkarkimin e saj, çështje e emërimit të saj në këtë pozitë dhe konkursi mbi të cilin është zgjedhur nuk ishin fare objekt i kësaj kërkesëpadie dhe i vendosjes në këtë çështje, andaj edhe gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e mënyrës se si ka ardhur paditësja deri në emërimin në pozitën e Kryeshefes Ekzekutive.

Gjykata vlerësojë edhe provat e tjera dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa ndikim dhe jorelevante në vendosjen e kësaj çështje juridike ku të njëjtat nuk lidheshin fare me çështjen e shkarkimit të paditëses nga pozita e Kryeshefes Ekzekutive të NP “Stacioni i Autobusëve” si objekt i vendosjes në këtë çështje kontestimore. Gjykata, e vlerësojë si provë edhe Statutin e NP “Stacioni i Autobusëve” vetëm nga aspekti i ekzistimit të të njëjtit apo jo (sepse Statuti është bazë ligjore dhe jo provë), sepse paditësja pretendonte se një nga arsyet e shkarkimit të saj lidhet me çështjen e miratimit të Statutit, mirëpo gjykata vlerësojë se Statuti i kësaj ndërmarrje është miratuar me datën 28.03.2013, pra një kohë të gjatë para se e njëjta të shkarkohej dhe nuk lidhet fare me shkarkimin e saj, përveç faktit se edhe ky Statut e ka rregulluar çështjen e emërimit të Kryeshefit Ekzekutiv nga ana e Bordit të Ndërmarrjes dhe atë dispozitat e nenit 6 dhe 15 të këtij Statuti.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së i cili duke marrë parasysh se paditësja humbi këtë çështje kontestimore, ndërsa e paditura Komuna e Mitrovicës i kërkojë shpenzimet procedurale dhe atë shumën në lartësi prej 540.80€, në emër të mbajtjes së dy seancave gjyqësore.



**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.447/2020, datë 26.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas marrjes së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.